



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSIEDNIKA

**STATUTI I KOMITETIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË
PRESIDENCË**

Prishtinë, 25 janar 2018



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PRESEDNIKA

Sekretari i Zyrës së Presidentit dhe Kryesuesi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Presidencë,
Në mbështetje të Nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, nr. 47, 25.01. 2009), Nenit 6 (2) të Ligjit Nr. 03/L-128 për Auditimin e Brendshëm (GZ Nr. 59, 29.10. 2009), Nenit 18 të Rregullores (P) Nr.02/2016 për Strukturën Organizative të Presidencës (08.09.2016), dhe Nenit 4 (1.14) të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave Nr. 11/2010 për Themelimin dhe Funksonimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik (11.08.2010), nxjerr:

**STATUTIN E KOMITETIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË
PRESIDENCË**

KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Statut përcaktohet përbërja, autoriteti, detyrat, përgjegjësit, thirrja dhe mbajtja e mbledhjeve, si dhe raportimi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Presidencë.

Neni 2
Fushëveprimi

Statuti zbatohet nga Anëtarët e Komitetit të Auditimit, Njësia e Auditimit, si dhe njësitë përkatëse të Presidencës.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Statut kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Komiteti i Auditimit** – Komiteti i Auditimit të Brendshëm në Presidencë;
 - 1.2. **Kryesuesi** – Kryesuesi i Komitetit të Auditimit;
 - 1.3. **Njësia e Auditimit** – Njësia e Auditimit të Brendshëm në Presidencë;
 - 1.4. **Presidencë** – Selia e aktivitetit zyrtar të Presidentit, që përfshin Kabinetin e Presidentit, Zyrën e Presidentit dhe institucionet/njësitë tjera të ndërlidhura;
 - 1.5. **Sekretar** – Sekretari i Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës;
 - 1.6. **Zyrë** – Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës.

KAPITULLI II – KOMITETI I AUDITIMIT NË PRESIDENCË

Neni 4 **Përbërja e Komitetit të Auditimit**

1. Komiteti i Auditimit themelohet me vendim të Sekretarit dhe përbëhet nga tre (3) anëtarë përfshirë edhe kryesuesin.
2. Mandati i Komitetit të Auditimit është tre (3) vjeçar, me të drejtë të riemërimit, por jo më shumë se dy (2) mandate rresht.

Neni 5 **Pavarësia**

1. Kryesuesi dhe Anëtarët e Komitetit të Auditimit janë të pavarur në punën e tyre dhe kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Asnjë person nuk mund të ushtrojë ose tenton të ushtrojë ndikim politik, administrativ, financiar ose ndikim tjetër në Komitetin e Auditimit.

Neni 6 **Kryesuesi dhe Anëtarët e Komitetit të Auditimit**

1. Kryesuesi dhe Anëtarët e Komitetit të Auditimit janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit të Auditimit dhe në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësiave në pajtim me këtë Statut dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Anëtari i Komitetit të Auditimit ka të drejtë që nëpërmjet Kryesuesit të kërkojë çdo informacion për veprimtarinë e Komitetit të Auditimit.

Neni 7

Dorëheqja

1. Kryesuesi dhe anëtarët e Komitetit të Auditimit mund të japin dorëheqje nga Komiteti i Auditimit.
2. Kryesuesi dhe anëtarët e Komitetit të Auditimit e njoftojnë Sekretarin për dorëheqjen e ofruar.
3. Anëtari që jep dorëheqje duhet të kryej të gjitha detyrat deri në caktimin e anëtarit të ri nga Sekretari.

Neni 8

Shkarkimi

1. Sekretari me Vendim mund t'i shkarkojë Kryesuesin dhe anëtarët e Komitetit të Auditimit vetëm nëse:
 - 1.1. Është dënuar për veprë penale nga Gjykata Kompetente;
 - 1.2. Kërkohet nga Komiteti i Auditimit që të bëjë shkarkimin.
2. Komiteti i Auditimit me shumicë votash mund ta kërkojë nga Sekretari që të shkarkojë secilin anëtar duke përfshirë edhe Kryesuesin e Komitetit të Auditimit nëse:
 - 2.1. Nuk i kryen detyrat që i janë dhënë nga Komiteti i Auditimit;
 - 2.2. Keqpërdor dhe/apo neglizhon pozitën e tij si anëtar i Komitetit të Auditimit;
 - 2.3. Nuk merr pjesë pa arsye në tri (3) herë radhazi në mbledhje të Komitetit të Auditimit.
3. Në rastet e shkarkimit të anëtarëve të Komitetit të Auditimit, Sekretari cakton anëtarin e ri.

KAPITULLI III – AUTORITETI, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIT E KOMITETIT TË AUDITIMIT

Neni 9

Autoriteti

1. Komiteti i Auditimit është organ i pavarur këshillëdhënës për menaxhmentin e lartë të Presidencës dhe mbështetës për Njësinë e Auditimit, duke:
 - 1.1. siguruar një mbikëqyrje të planeve dhe rezultateve të auditimit;
 - 1.2. siguruar pavarësinë e Njësisë së Auditimit;
 - 1.3. vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;
 - 1.4. siguruar që rekomandimet e auditimit janë pranuar dhe zbatuar;
 - 1.5. këshilluar mbi çështjet lidhur me rreziqet, sistemet e kontrollit të brendshëm dhe auditimit.

Neni 10

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Komiteti i Auditimit ka për detyrë dhe përgjegjësi të:
 - 1.1. Ofrojë këshilla në të gjitha fushat të përgjegjësisë së menaxhmentit për Kontrollin e Brendshëm të Financave në Presidencë;
 - 1.2. Sigurojë që menaxhmenti i Zyrës, realizon veprimtarinë në pajtueshmëri me të gjitha detyrimet ligjore në fuqi;
 - 1.3. Rishikojë dhe aprovojë por jo drejtoj strategjinë e auditimit dhe planet vjetore të Njesisë së Auditimit;
 - 1.4. Rishikoj raportet përmbledhëse të auditimit të brendshëm, të gjeturat dhe rekomandimet që dalin, si dhe të kërkoj siguri se Menaxhmenti i Presidencës i ka adresuar këto si duhet;
 - 1.5. Rishikoj deklaratat financiare, opinionin e auditimit të jashtëm dhe raportet;
 - 1.6. Rishikoj përgjigjen e menaxhmentit ndaj çështjeve të ngritura nga auditimi i jashtëm;
 - 1.7. Siguroj se ekziston një marrëdhënie efektive në mes të menaxhmentit, Njesisë së Auditimit dhe Auditorit të jashtëm;
 - 1.8. Mbroj pavarësinë funksionale të Njesisë së Auditimit;
 - 1.9. Vlerësoj përshtatshmërinë e burimeve të auditimit të brendshëm;
 - 1.10. Siguroj që mashtrimi potencial ose korrupsioni i dyshuar i identifikuar në raportin e auditimit ose nëse Komiteti i Auditimit, është vënë në dijeni për këtë në ndonjë mënyrë tjetër, raportohen tek autoritetet kompetente;
 - 1.11. Këshilloj mbi çështjet lidhur me rreziqet e identifikuara dhe sistemin e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Presidencë;
 - 1.12. Mbaj të dhëna për të gjitha mbledhjet së bashku me raportet e ofruara nga funksioni i auditimit të brendshëm, dhe të gjitha të dhënat e shkruara për të gjitha çështjet dhe dëshmitë që lidhen me këto raporte si dhe veprimet që merren nga Komiteti i Auditimit;
 - 1.13. Ofroj qasje të plotë dhe të papenguar në të gjitha të dhënat ose raportet e përgatitura apo të mirëmbajtura nga Komitetit i Auditimit, me kërkesë të auditorit gjeneral ose autoritetit publik që ka funksione hetuese ose kontrolluese;

KAPITULLI IV – MBLEDHJET DHE RAPORTIMI I KOMITETIT TË AUDITIMIT

Neni 11

Mbledhjet e Komitetit të Auditimit

1. Komiteti i Auditimit mbanë së paku katër (4) mbledhje në vit.
2. Mbledhjet e Komitetit të Auditimit ftohen nga Kryesuesi.
3. Drejtori i Njesisë së Auditimit ftohet në të gjitha mbledhjet e Komitetit të Auditimit.
4. Kryesuesi mund të thërras mbledhje shtesë sipas nevojës.
5. Sekretari, mund të kërkojë mbajtjen e mbledhjeve të tjera për të diskutuar çështje të caktuara, për të cilat kërkojnë këshilla nga Komiteti i Auditimit.
6. Komiteti i Auditimit me qëllim të realizimit të detyrave dhe përgjegjësi të tij, në mbledhje mund të ftojë edhe zyrtarët e Presidencës për të diskutuar çështjet e auditimit të brendshëm.
7. Kur kërkohen informata shtesë, Komiteti i Auditimit mund të ftojë persona tjerë të kualifikuar, brenda ose jashtë Presidencës, për të ofruar përvojën e tyre sipas nevojës.
8. Mbledhja e Komitetit të Auditimit, është e vlefshme kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve.

Neni 12

Procesverbali i mbledhjes

1. Për çdo mbledhje të Komitetit të Auditimit mbahet procesverbal.
2. Në procesverbal bëhet një përmbledhje e diskutimit, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan dhe konkluzionet e arritura.
3. Procesverbali, pas nënshkrimit, i përcillet për njoftim Shefit të Stafit të Kabinetit të Presidentit dhe Sekretarit.

Neni 13

Raporti Vjetor

1. Komiteti i Auditimit, përgatit raportin vjetor, në të cilin përfshihet:
 - 1.1. Përbërja e Komitetit të Auditimit, detyrat dhe realizimi i tyre;
 - 1.2. Përshtatshmëria e sistemit të menaxhimit të rreziqeve dhe rrugët për mënjanimin e tyre;
 - 1.3. Gjendja financiare dhe përshtatshmëria e sistemit të menaxhimit financiar dhe raportues të Presidencës;
 - 1.4. Pavarësia e Auditorit të Brendshëm dhe efektiviteti i Njesisë së Auditimit;
 - 1.5. Përshtatshmëria e ambientit të kontrollit të brendshëm për të siguruar operacione efektive, efikase dhe të ligjshme;

- 1.6. Efikasiteti i Njesisë së Auditimit në rishikimin e sistemeve të menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit të brendshëm dhe dhënia e rekomandimeve të vlefshme për menaxhmentin e lartë, për përmirësimin e tyre.
- 1.7. Ndonjë mangësi të madhe të sistemit, e cila rrezikon Presidencën.
2. Raporti vjetor i dërgohet Shefit të Stafit të Kabinetit të Presidentit dhe Sekretarit, më së largu deri me 31 mars të vitit vijues për vitin paraprak.

KAPITULLI V - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Buxheti dhe Kompensimi

1. Kryesuesi dhe anëtarët e Komitetit të Auditimit gëzojnë të drejtën e kompensimit në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 34/2012 për pagesën e pagave dhe shtesave të Kryetarëve /Kryesuesve dhe të Anëtarëve të Bordit për Rishqyrtimin e Ankesave, Komiteteve të Auditimit, Këshillit Kosovar për Raportim Financiar (27.12.2012).
2. Sekretari siguron buxhetin e nevojshëm, për punën, angazhimin, pjesëmarrjen në mbledhje si dhe funksionimin e përgjithshëm të Komitetit të Auditimit.

Neni 15

Bashkëpunimi dhe Mbështetja e Komitetit të Auditimit

Të gjitha njësitë e Presidencës obligohen që të bashkëpunojnë dhe t'i ofrojnë mbështetje Komitetit të Auditimit, për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij.

Neni 16

Rishikimi i Statutit

Rishikimi i këtij Statuti, duke përfshirë edhe ndryshim plotësimin e tij, bëhet në mënyrën e njëjtë të miratimit të tij.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Zijush Ahmeti

Fehmi Mehmeti

Kryesues i Komitetit të Auditimit të Brendshëm
në Zyrën e Presidentit

U.D. Sekretar i Zyrës së Presidentit

Prishtinë, 25 janar 2018